

VENDIM
Nr. 254, datë 20.4.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, TË RREGULLAVE E PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në ndarjen e dytë “Institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, shtohet emërtesa “Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;
 - b) Në ndarjen e tretë “Institucione në varësi të Kryeministrit”, shtohet emërtesa “Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe emërtesa “Komiteti Shtetëror i Minoriteteve” ndryshohet me “Komiteti për Pakicat Kombëtare”.
2. Në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa:
 - a) Në ndarjen “Për grupin e dytë”, të shkronjës “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji”, shtohen funksionet:
 - i. “Specialist i Bërthamës Komanduese Elektronike/hetues financiar/ekspertë në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”;
 - ii. “Ndihmës - inspektor në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë”.
3. Shkronja “ç”, e pikës 11, të këtij vendimi, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Funksioni/pozicioni “Kryetar i këshillit të rrethit” dhe “Kryetar i Komitetit Ekzekutiv Pluralist”, zëvendësohet me “Kryetarit të bashkisë”, si dhe pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm në këshillin e rrethit” zëvendësohet me “Sekretar i Përgjithshëm në bashki”.
4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku